



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 17 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2, të Ligjit Nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019, e konform nenit 17 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 15 dhe 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M
Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, për parcelat P-72116038-00503-0 dhe P-72116003-00944-0, si pas vendimit paraprak 01-Nr-016-57289, të datës 31.08.2022.

Neni 2

Komisioni nga neni 1, (një) i këtij vendimi përbëhet prej 5, (pesë) anëtarëve dhe do të jetë kjo përbërje:

- 2.1 --përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës
- 2.2 --përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
- 2.3 --përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
- 2.4 --përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
- 2.5 --përfaqësuese nga sektori jo qeveritar

Neni 3

Komisioni do të kryen punën pas marrjes së vendimit paraprak nga Kuvendi i Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Detyrat dhe përgjegjësit e komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, janë të përcaktuara me dispozita ligjore të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-10/2019”, komisioni ka autoritet, mandat dhe kompetencë të bëjë njoftimin publikë për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të përcaktoj çmimin fillestar, kushtet dhe kriteret specifik gjatë ankandit publik dhe shprehjes së interesit.

Neni 5

Obligohet zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, ti zhvillojnë procedurat e ankandit publikë, shprehjes së interesit dhe vlerësimin e ofertave.

Neni 6

6.1 Për punën që do ta kryej komision do të kompensohet nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Komunës së Suharekës.

6.2 Anëtarët e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhën më shumë se 6, (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda viti kalendarik.

Neni 7

Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 8

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI